



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M

K.P.P. 5/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 08.01.2021 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: “Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar” me Nr. REF-80581-12-01-2020 me objekt: “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore, sipas listës së miratuar nga OBSH” – Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj me fond limit 496,000,000, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 18.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.”

Ankimues: “NOA Energy Trade” sh.p.k.
Rruga “Nikolla Tupe”, Ndërtesa nr. 3, Kati 1, Tiranë

Autoriteti kontraktor: Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale
Rruga e Kavajës, nr. 1001, Tiranë

Baza Ligjore: Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”*, i ndryshuar.

I.3. Nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 02.12.2020 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *“E Hapur mbi kufirin e larte monetar”* me Nr. REF-80581-12-01-2020 me objekt: *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore, sipas listës së miratuar nga OBSH*” –Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj me fond limit 496,000,000, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 18.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

II.2. Në datën 09.12.2020 operatori ekonomik *“NOA Energy Trade”* sh.p.k ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke ngritur pretendime mbi hartimin e dokumentave të tenderit, të procedurës objekt ankimi. Konkretisht pretendohet si vijon:

“I referohemi dokumenteve standarde te procedures se hapur (mbi kufirin e larte monetar) per Mallra: "Blerje teste diagnostike antigenike te shpejta per SARS-COV-2 per nevoja te NJVKSH-ve per nje periudhe 12 Mujore, sipas listes se miratuar nga OBSH" - Marreveshje kuader me nje operator ekonomik - ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj me fond limit 496,000,000. 00 (katerqind e nentedhjte e gjashte milion) leke pa TVSH, REF-80581-12-01-2020.

Sipas verifikimit të faqes së internetit të APP-se, njoftimi i publikimit të Kontrates është bere me 02.12.20201, dhe në bazë të nenit 63 të Ligjit "Për Prokurimin Publik" ("LPP"), po parashtrojme këto ankesë kundrejt kriterëve të përmbajtura në dokumentet e tenderit ("DST"), brenda afatit 7 (shtatë) ditë nga data e njoftimit të publikimit të Kontrates në faqen e internetit të APP, dhe në cilësinë e personit që ka interes në këtë procedurë prokurimi dhe rrezikohet të demtohet nga vendimi i Autoritetit Kontraktor i marrë në kundërshtim me LPP kuadrin rregullator nënligjor përkatës.

Operatori ekonomik ankimes, në bazë dhe referencë të kuadrit rregullator të zbatueshëm dhe sa më lart, parashtron ankesën e mëposhtme.

Tek Shtojca 9 e DST përmbahen kriteret e vecanta të kualifikimit dhe ndërmjet tyre parashikohen edhe kriteret e kapacitetit teknik (pika 2.3 e Shtojcës 9) ku Operatorit Ekonomik i kerkohet përmbushja e kërkesave të mëposhtme minimale:

1. Furnizime të mëparshme të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 198,000,000.00 (nëqind e nentëdhjetë e tetë milion) lekë të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e hapjes së ofertave të kësaj procedurë prokurimi. Si dëshmi për pervojën e mëparshme kerkohen vertetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara. Në rastin e pervojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat si dëshmi pranohen vetëm faturat tatimore të shitjes, ku të shenohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Kriteri i lartpërmendur vjen në kundërshtim të plotë dhe flagrant jo vetëm me parimet kryesore dhe qëllimet e kuadrit rregullator në fuqi (neni 1 dhe 2 i LPP parashikon nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë, nxitje të konkurrencës ndërmjet tyre, trajtim të barabartë dhe jo diskriminues, integritet, besim publik dhe transparencë, etj) por edhe me rrethanat faktike që kanë kushtezuar dhe diktuar nevojën e kryerjes së kësaj procedurë prokurimi publik.

Kështu, duke ju referuar objektit të DST, behet fjale për blerje testesh për SARS-COV 2, një fenomen negativ i zhvilluar dhe përhapur në vend prej jo më pak se një vit. Nderkohe që masat e ndërmarrja kundër këtij fenomeni në Shqipëri, si ato me natyrë parandaluese ashtu edhe ato me natyrë kuruese kanë qenë shumë dinamike në zhvillimin e tyre, përfshirë edhe kahe diametralisht të kundërt të këtij zhvillimi. Rrjedhimisht vetëm në Nentor është zhvilluar një procedurë e ngjashme me procedurën në fjale dhe, sikundër kuptohet lehtësisht, do të ishte teorikisht dhe praktikisht i pamundur plotësimi i kriterit të lartpërmendur nga një game operatorësh të udhëhequr nga mosdiskriminimi, pjesëmarrja e gjere në tender, transparencë, etj. Një kriter i tillë rezultoi ekstremisht kufizues dhe faktor thelbësor për paracaktimin e operatorit fitues, duke rezultuar kështu në kundërshtim thelbësor dhe flagrant si me parimet e prokurimit publik, ashtu edhe me rregullat që duhet të ndiqen në zhvillimin e kësaj procedurave.

Bazuar dhe referuar në sa më lart, në vlerësime të nevojshme heqjen e këtij kriteri si një kriter me natyrë diskriminuese, jo transparente dhe në kundërshtim të plotë me interesat publike, që në lidhje me procedurën në fjale kanë rëndësi jetike.

Mbetemi në dispozicion dhe të angazhuar maksimalisht për t'iu siguruar çdo informacion/dokumentacion që mund të rezultojë i nevojshëm në procesin e konsultimit dhe zgjidhjes së ankesës tone, në mënyrë që të sigurohet një mbarevajtje e kësaj procedurë

ne pajtueshmeri te plote me parimet dhe kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i zbatueshem per zhvillimin e procedurave te prokurimit”.

II.3. Nëpërmjet shkresës nr. 5259/5 datë 14.12.2020 me objekt “Kthim përgjigje”, autoriteti kontraktor i ka kërkuar ankimuesit korrigjimin e ankesës brenda 48 orëve si më poshtë:

“Ne pergjigje te ankeses suaj nr.5250/3 prot., date 09.12.2020, me objekt "Ankese kunder dokumentave te tenderit" me ane te ciles kerkoni heqjen e kriterit te parashikuar ne Shtojcen 9 te DST pika 2 Kriteret e Vecanta te Kualifikimit «2.3.1.Furnizime te meparshme te ngjashme ne nje vlere jo me te vogel se 198,000,000 leke, te realizuara gjate tre viteve te fundit nga data e hapjes se ofertave te kesaj procedure prokurimi. Si deshmi per pervojen e meparshme kerkohen vertetime te leshuara nga nje ent publik ose fatura tatimore te shitjes, ku shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara. Ne rastin e pervojes se meparshme te realizuar me sektorin privat si deshmi pranohen vetem faturat tatimore te shitjes ku te shenohen datat, shumat dhe sasite e mallrave te furnizuara.» si nje kriter me natyre diskriminuese, jotransparente dhe ne kundërshtim te plote me interesat publike, drejtuar Ministrise se Shendetesise dhe Mbrojtjes Sociale, ju sqarojme si vijon:

Ne lidhje me ankesen e paraqitur nga ana juaj, per proceduren e prokurimit me objekt "Blerje teste diagnostike antigenike te shpejta per SARS-COV-2 per nevoja te NJVKSH-ve" per nje periudhe 12 mujore, sipas listes se miratuar nga OBSH" - Marreveshje Kuader me nje operator ekonomik - ku te gjitha kushtet jane te percaktuara - me afat 12 muaj me fond limit 496,000,000 (katerqind e nentëdhjete e gjashte milion) Ieke pa TVSH, REF-80581-12-01-2020 referuar VKM nr. 914, date 29.12.2014 "Per miratimin e rregullave per Prokurimin Publik", e ndryshuar, neni 20, ankesa kunder veprimeve ose mosveprimeve te autoritetit kontraktor, operatorët ekonomike te interesuar mund te bejne ankese prane ketij te fundit, nepermjet nje formulari standard, i cili permban udhezimet e nevojshme per plotesimin dhe nenshkrimin e tij» si dhe Kreu X Shqyrtimi i Ankesave «Neni 78 pika 3. Ankimuesi perdor formularin standard te ankeses, qe permban emrin, adresen, adresen elektronike te ankimuesit, referencen e procedures konkrete, bazen ligjore, si dhe nje pershkrim te shkeljes se pretenduar. Kur eshte e mundur, ankimit i bashkelidhet nje kopje e aktit, qe kundërshtohet. Nese mungon ndonjeri nga elementet e siperpermendura ose formulari nuk eshte plotësuar ne menyren e duhur, atehere autoriteti kontraktor duhet te vere ne dijeni ankimuesin per te plotësuar formularin. Njoftimi mund te behet me cdo mjet te mundshem, perfshire dhe posten elektronike, dhe ne cdo rast dokumentohet nga zyrtari perkates. Nese ankesa nuk korrigjohet brenda 48 (dyzet e tete) oreve pas njoftimit, ajo vlerësohet si e paparaqitur. Formulari i ankeses eshte pjese e dokumenteve standarde te tenderit, te cilat jane te publikuara ne faqen e internetit te APP-se», rezulton se ankesa juaj nuk eshte paraqitur sipas formatit te kerkuar dhe per rrjedhoje nuk mund te merret ne shqyrtim.

Persa me siper, ju lutem plotësoni ankesen sipas Shtojca 20 "Formulari i Ankeses prane Autoritetit Kontraktor" te DST.”

Kjo shkresë ka arritur në adresën e ankimuesit në datën 18.12.2020.

II.4. Në datë 18.12.2020 ankimuesi ka dorezuar ankesen e korrigjuar prane autoritetit kontraktor, e cila është protokolluar në AK me nr. 5250/6 prot.

II.5. Nëpërmjet shkresës nr.5250/8 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së ankimuesit (datë 18.12.2020), duke e refuzuar ankesën. Sipas ankimuesit *“autoriteti kontraktor me emailin e datës 24.12.2020, ora 18.16 ka dërguar shkresën nr.5250/8 prot., dt.22.12.2020, me anë të së cilës, subjekti ankimues ka patur mundësi të njihet vetëm në datë 28.12.2020”*.

II.6. Në datën 06.01.2021 ankimuesi ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës si dhe dokumentacionit bashkëngjitur kësaj ankese,

Arsyeton

III.1. Në datën 02.12.2020 është publikuar nga autoriteti kontraktor, në sistemin elektronik të prokurimeve të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit *“E Hapur mbi kufirin e larte monetar”* me Nr. REF-80581-12-01-2020 me objekt: *“Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore, sipas listës së miratuar nga OBSH* –Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj me fond limit 496,000,000, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me date 18.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

III.2. Referuar parashtimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues *“NOA Energy Trade” sh.p.k.*, si dhe dokumentacionit bashkëlidhur ankesës, konstatohet se ky i fundit ka dorëzuar ankim pranë autoritetit kontraktor në datën 09.12.2020. Në ankesë ngrihen pretendime lidhur me hartimin e dokumentave të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.3. Referuar materialeve të administruara, parashtimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se, nëpërmjet shkresës nr. 5259/5 datë 14.12.2020 me objekt *“Kthim përgjigje”*, autoriteti kontraktor i ka kërkuar ankimuesit korrigjimin e ankesës brenda 48 orëve. Kjo shkresë ka arritur në adresën e ankimuesit në datën 18.12.2020

III.4. Referuar materialeve të administruara, parashtimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, si dhe dokumentacionit dorëzuar nga ky i fundit pjesë e ankimit pranë Komisionit të Prokurimit Publik, konstatohet se në datë 18.12.2020 ankimuesi ka dorëzuar ankesën e korrigjuar pranë autoritetit kontraktor, e cila është protokolluar në AK me nr. 5250/6 prot.

III.5. Nëpërmjet shkresës nr.5250/8 prot., datë 22.12.2020 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së ankimuesit (datë 18.12.2020), duke e refuzuar ankesën. Sipas ankimuesit *“autoriteti kontraktor me emailin e datës 24.12.2020, ora 18.16 ka dërguar shkresën nr.5250/8 prot., dt.22.12.2020, me anë të së cilës, subjekti ankimues ka patur mundësi të njihet vetëm në datë 28.12.2020”*.

III.6. Në datën 06.01.2021 ankimuesi ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

III.7. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar: “1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1. Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik.

Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

3. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi përpara skadimit të afatit kohor, të përcaktuara në pikat 5 dhe 6 të këtij neni.

5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.8. Në rastin konkret, rezulton se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pranë autoritetit kontraktor në datën 09.12.2020. Referuar pohimit të operatorit ekonomik ankimues, dhe dokumentacionit bashkëngjitur ankesës, autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje ankesës së operatorit ekonomik “NOA Energy Trade” sh.p.k., duke kërkuar korrigjimin e saj brenda 48 orëve. Konstatohet se kjo përgjigje ka mbërritur në adresën e ankimuesit në datën 18.12.2020 dhe në të njëjtën datë ankimuesi ka dërguar në AK formularin e ankesës të korrigjuar dhe të protokolluar në të njëjtën datë nga AK me nr. 5250/6 prot. Autoriteti kontraktor e ka refuzuar ankesën e operatorit ekonomik “NOA Energy Trade” sh.p.k nëpërmjet shkresës nr 5250/8 prot., datë 22.12.2020, por që ky i fundit pretendon se “autoriteti kontraktor me emailin e datës 24.12.2020, ora 18.16 ka dërguar shkresën nr.5250/8 prot., dt.22.12.2020, me anë të së cilës, subjekti ankimues ka patur mundësi të njihet vetëm në datë 28.12.2020”.

III.9. Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ankimi i dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues më datë 06.01.2020 është dorëzuar jashtë afatit të parashikuar nga lex specialis, pasi referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë KPP nis ose nga dita e nesërme e punës pas përfundimit të afatit të shqyrtimit të ankesës nga autoriteti kontraktor, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor dhe përfundon ditën e dhjetë. Duke qënë se ankimuesi ka paraqitur ankesën e korrigjuar në datën 18.12.2020 në autoritetin kontraktor, ky i fundit duhet të *nxirrte një vendim brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës*. Pra si në supozimin se autoriteti kontraktor ka kthyer përgjigje në datën 22.12.2020, ashtu edhe në supozimin se ankimuesi është vënë në dijeni të përgjigjes së AK në datën 28.12.2020 (ose dhe në datën 24.12.2020), rezulton se ankesa e paraqitur nga shoqëria “NOA Energy Trade” sh.p.k pranë Komisionit të Prokurimit Publik në datë 06.01.2021, është depozituar në tejkalim të afateve ligjore të parashikuara në nenin 63 të LPP-së si më sipër cituar.

III.10. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se, ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” që, referuar nenit 26, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “*Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, ndaj përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për shkak të mosrespektimit të afateve të ankimit. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

III.11. Duke mbajtur në konsideratë faktin që, sipas ligjit në fuqi, shqyrtimi administrativ i nënshtrohet dy fazave: asaj të shqyrtimit paraprak (në të cilin vlerësohen forma e ankimit, legjitimiti, juridiksioni, kompetenca dhe nuk i jepet zgjidhje në thelb ankimit) dhe asaj të shqyrtimit në themel të ankimit, në rastin në fjalë, ankimi administrativ i paraqitur nga operatori ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik nuk mund të konsiderohet si ezaurim i afateve ligjore që duhet të ndjekë një ankim administrativ pasi, për faj të vetë ankimuesit, ankimi nuk është realizuar sipas kriterëve të domosdoshme të përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*”, i ndryshuar.

Komisioni Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij se, për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj edhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si *lex specialis* mbi lëndën.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “NOA Energy Trade” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “E Hapur mbi kufirin e larte monetar” me Nr. REF-80581-12-01-2020 me objekt: “Blerje teste diagnostike antigenike të shpejta për SARS-COV-2 për nevoja të NJVKSH-ve” për një periudhë 12 mujore, sipas listës së miratuar nga OBSH” –Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik - ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj me fond limit 496,000,000, pa TVSH, parashikuar për tu zhvilluar me dt. 18.01.2021, nga autoriteti kontraktor, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
2. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
3. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr.17 Protokolli,

Datë 06.01.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Enkeleda Bega

Anëtar
Vilma Zhupaj

Anëtar
Lindita Skeja

Anëtar
Merita Zeqaj

Kryetar
Jonaïd Myzyri